

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale ndërtimi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
441100000-1 Materiale ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: Marrëveshje kuadër me fond limit total: 18 332 906 (tetëmbëdhjetëmilion e treqindetridhjetedymijë e nëntëqindëgjashtë) lekë pa TVSH ose 187 204.18 (njëqindetëtdhjeteshtatëmijë e dyqindekatër pikë tetëmbëdhjetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 10.06.2025 është 97.93 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*. Në rastin konkret, nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit*

përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin emnistrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës

me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre me sektorin publik dhe/ose atë privat.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 5 (pesë) persona.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazes së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- *Listpagesën e fundit sipas formularit standart për sigurimet;*
- *Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Nisur nga mallrat, objekt prokurimi, të cilat janë parashikuar në preventiv që do të dorëzohen në destinacione të ndryshme sipas përcaktimeve të kryera nga AK, nevojiten 3 (tre) punonjës të cilët duhet të jenë si drejtues të automjeteve betoniere, 1 (një) punonjës drejtues automjeti kamion vetshkarkues dhe 1 (një) punonjës si punëtor për ngarkim-shkarkimin e mallit.

2.3.3 Operatorët Ekonomik duhet të kenë të punësuar 3 (tre) drejtues automjeteve për autobetoniere dhe 1 (një) drejtues mjeti për kamion vetshkarkues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të sipërpërmendur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- kontratë pune të vlefshme;
- dëshminë e drejtimit të automjetit të vlefshme;
- si dhe të figurojnë në listpagesën e sigurimeve shoqërore.

Në rastin kur makineritë disponohen me qera, për drejtuesit e mjeteve nuk do të kërkojen listëpagesat e sigurimeve shoqërore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për dorëzimin e mallrave sipas zërave të preventivit në pikat e përcaktuara nga AK, kërkojnë specialistët e sipërpërmendur.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë impiant prodhimi betoni pronësi/përdorim/qira ose kontratë furnizimi për mallin objekt prokurimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e impiantit të prodhimit të betonit pronësi/përdorim/qira ose kontratë furnizimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Ne rastin e impiantit në pronësi:

- Dokumentat e pronësisë së impiantit
- Leje mjedisore kodi III.1.b.

Në rastin e impiantit me përdorim/qera:

- Kontratën e huapërdorjes/qerasë lidhur para noterit, shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë të impiantit të prodhimit të betonit si dhe Lejen mjedisore kodi III.1.b, me afat deri në përfundim të kontratës.

Në rastin e kontratës së furnizimit:

- Kontratë furnizimi lidhur para noterit, shoqëruar me dokumentacionin e pronësisë të impiantit të prodhimit të betonit, me afat deri në përfundim të kontratës, si dhe të ketë të përcaktuar sasinë e betonit të kërkuar nga AK.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion me /huapërdorjeqera ose kontratë furnizimi impiant për prodhim betoni i domosdoshëm për të përmbushur kontratën.

Është kërkuar ky impiant në përputhje me volumet e zërave të preventivit, llojit të mallit, konkretisht beton i gatshëm C 20/25, me një volum të përgjithshëm prej 1.850 m³, përcaktuar sipas manualit të MPPT miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 ” Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autobetoniere	3 copë	pronësi/përdorim/qira
2	Kamion vetshkarkues me vinç me kapacitet mbi 15 T	1 copë	pronësi/përdorim/qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e makinerive të sipërpërmendura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. Certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Policë sigurimi (e vlefshme)

4. *Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme*

Për mjetet me përdorim/qiera,

1. *Për mjetet e marra me përdorim/qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e huapërdorjes/qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, i cili duhet të jetë deri në përfundim të kontratës.*
2. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
3. *Certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)*
4. *Policë sigurimi (e vlefshme)*
5. *Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se „5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit“.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Janë kërkuar këto makineri në përputhje me volumet e zërave të preventivit. Malli beton C 20/25 me një volum të përgjithshëm prej 1.850 m³ objekt prokurimi do të transportohen e më tej dorëzohen në pikat e përcaktuara nga AK me autobetoniere. Janë kërkuar 3 (tre) autobetoniera pasi nga AK është parashikuar që në ditë të caktuara do të merret një sasi e konsiderueshme betoni për tu përdorur për rikonstrukcion rrugësh të fshatrave të Bashkisë me vendodhje të largëta, çka kushtëzon që furnizimi të kryhet nga 3 (tre) autobetoniere për të realizuar me efikasitet punën e parashikuar. Mallrat e tjera të përfshira në preventiv do të transportohen me kamion veshkarkues gjithashtu në pikat e përcaktuara nga AK. Kamioni duhet të jetë me vinç pasi do të kryejë njëkohesisht ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave objekt prokurimi.

2.3.6 *Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:*

- *Certifikat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 77, pika 4, VKM nr. 285, dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 ku parashikohet se „Kërkesat e cilësisë 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit“, si dhe natyrës së mallrave që do të furnizohet AK. Kriteri që OE duhet të disponojë certifikatë të sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së mallrave që ofron.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Emërtesat e produkteve dhe njësitë janë marrë nga Manuali Teknik i Çmimeve për Punimet e Ndertimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Manuali 1, Materiale ndertimi), duke shtuar edhe transportin për zërin e betonit deri në objekt në distancën 10 km. (Analiza 2.37/5b - 467.28 lek/m³), përcaktohen edhe specifikimet teknike të detajuara sipas Standarteve në Shtetin Shqiptar në fuqi dhe në atë Evropian, për sa më poshtë vijon:

• BETON I GATSHËM STRUKTUROR C20/25

Operatori ekonomik do të furnizojë me beton të gatshëm C20/25 NSHP Himarë duke respektuar Standartin Shqiptar dhe atë Europian SSH-EN206 si dhe “Rregullat teknike për përdorimin e betoneve strukturore” miratuar me V.K.M. Nr. 679 Datë 22.10.2004 “Për miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore”.

Betoni i gatshëm strukturor klasifikohet në bazë të rezistencës në shtypje e shprehur në rezistencë karakteristike R_{ck} ose f_{ck} . Për betonin e gatshëm C20/25 vlerat e provave në shtypje pas 28 ditësh ngurtësimi të kubikëve të betonit të marra në objekt duhet të jenë në shifrat e mëposhtme: $f_{ck} = 20 \text{ N/mm}^2$ (Vlera e marrë nga provat në shtypje mbi cilindrin me diametër 150mm dhe lartësi 300mm) $f_{ck, cube} (\text{MPa}) = 25 \text{ N/mm}^2$ (Vlera e marrë nga provat në shtypje mbi kubikët me brinjë 150mm).

Porosia e betonit të gatshëm C20/25 tek kontraktori për sasinë, kohën dhe objektin ku do të përdoret, do të bëhet nga NSHP Himarë (në rolin e blerësit), 2 ditë para ditës së furnizimit.

Sasia e betonit të gatshëm që kërkon të furnizohet NSHP Himarë do të përdoret në rikonstruksionin e akseve rurale e lokale të kesaj bashkie. Kontraktori ka për detyrë marrjen e mostrave të betonit në objekt për të provuar rezistencën e betonit në shtypje në prani të përfaqësuesit të Kontraktuesit (NSHP Himarë) si dhe kryerjen e provave laboratorike për

përcaktimin e rezistencës së betonit në shtypje pas 28 ditësh ngurtësimi dhe rezultatet e provave duhet të jenë në shifrat e përmendura më lart.

Këto prova përbëjnë edhe certifikatën e cilësisë së betonit të hedhur në objekt. Trajtimi, mirëmbajtja dhe provat laboratorike të mostrave të betonit për markën e betonit strukturor C20/25 janë detyrë e subjektit kontraktor pasi pa ato nuk mund të kryhet likujdimi financiar për materialin e shitur pranë NSHP Himarë.

Kontaktori duhet të bëjë furnizimin me beton të gatshëm, transportin si edhe hedhjen e tij në objektet e Infrastrukturës rrugore të Bashkisë Himarë. Koha optimale që nevojitet nga momenti i prodhimit të betonit të gatshëm në nyjën e betonit, transportin dhe hedhja e tij në objekt është 1 orë, kohë që korrespondon brenda kohës së prezës (ngurtësimin) e betonit (3 orë) për të pasur betone cilesorë në objekte.

- **INERTET** (të imta dhe të trasha) për të gjitha tipet e betonit duhet të përdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose në përputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale”. Ato duhet të jenë të fortë dhe të qëndrueshëm dhe nuk duhet të përmbajnë materiale të dëmshme që veprojnë kundër fortësisë ose qëndrueshmërisë së betonit ose, në rast të betonarmesë mund të shkatërrojë këtë përforsim. Materialet e përdorura si inerte duhet të përftohen nga burimet të njohura për të arritur rezultate të kënaqshme për klasa të ndryshme të betonit duke respektuar standartet e mësipërme.

- **RËRË GURI DHE ÇAKËLL** makinerie e prodhuar nga thyerja dhe fraksionimi në makineri i materialeve gurore ose zhavorre lumi me fortësi 800 kg/cm² dhe të respektojë kushtet teknike të Standartit Shqiptar STASH-512-78 ose në përputhje me ASTM C 33 “Inertet e betonit nga burime natyrale” dhe të mos ketë përmbajtje të huaj argjilore më shumë se 5% dhe material organike jo më shumë se 3%. Rëra e makinerisë duhet të ketë granulometrine (1-5)mm, ndërsa çakëlli i makinerisë (10-50)mm.

- **GURË KAVE**

Duhet të jenë të prodhuara në kariera guri, të kenë fortësi 600-800 kg/cm², përmbajtje të argjilës më pak se 10% dhe përmbajtje të mbeturinave bimore më pak se 5%. Gurët e kavës do të përdoren nga enti prokurues për ndërtimin e mureve pritëse e mbajtëse në akset rrugore të tij.

- **TOMBINO Ø 600mm, Ø800mm, Ø1000mm**

Tombinot duhet të jene rrethore me dimensionet e mësipërme që i korrespondon diametrit të brendshëm, duhet të përballojnë ngarkesat e lëvizshme N-18 dhe T-80 dhe të prodhohen në përputhje me Standartin Shtetëror në fuqi STASH-2503-87. Tombinot me diametër 400mm dhe 600mm janë betoni ndërsa ato me diametër 800mm dhe 1000mm janë beton-arme dhe trashësi të pareteve t= 10cm. Gjatësia e tubit të betonit- 1ml dhe klasa e betonit C20/25.

- **ÇIMENTO**

Duhet të jetë tipit “Portland”, 42.5R në thasë 25kg ose 50kg dhe në përputhje me kushtet e Standartit Shtetëror STASH-501-87, 503-87. Çertifikata e cilësisë dhe fletet e analizave të fabrikave që kanë prodhuar çimenton duhet të shoqërojnë çdo furnizim sipas porosisë së entit kontraktor, duke vërtetuar që çimentoja është e testuar dhe i ka plotësuar kërkesat e përmendura më lart. Transporti në objektet e Bashkisë ose magazinë duhet të behet nga kontraktori në paketa origjinale të shënuara direkt nga fabrika e prodhimit të çimentos dhe të ruajtura në kushte të duhura.

- **STABILIZANTI**

Të jetë i prodhuar nga materiale gurore i thyer, i fraksionuar dhe të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

-Fortësia e gurëve përbërës $\geq 800\text{kg/cm}^2$

-Marka e thermimit nga prova Losanxhelos $LA \leq 30\%$

-Permbajtja e argjiles deri në 5% dhe materialeve organike deri në 3%

- **ZGARA HEKURI**

Zgarë hekuri për shtresa betoni në rrugë duhet të jetë me hekur $\varnothing 4\text{mm}$ dhe me përmasa të zgarës $(4.70 \times 2)\text{ m}$ si dhe me përmasa të kuadratit të zgarës $(25 \times 25)\text{ cm}$.

- **DËRRASA PISHE**

Dërrasa e pishës duhet të jetë 5cm, e stazhionuar, e skuadruar dhe pa plasaritje, e vendit dhe me gjatësi $L = (3.5 \div 4)\text{m}$. Sasia e dërrasës së dorezuar tek blerësi duhet të shoqërohet me çertifikatën e cilësisë së mallit të lëshuar nga subjekti prodhues.

- **BORDURA BETONI** me përmasa $(15 \times 35 \times 100)\text{ cm}$ me klasë rezistence të betonit C20/25, konform STASH 505-56 “rëra per betone” dhe STASH 504-56 “Zalli dhe çakëlli për betone”

- **ÇAKËLL MBETURINE PËR MBUSHJE**

Çakëll makinerie e prodhuar nga thyerja dhe fraksionimi në makineri i materialeve gurore ose zhavorre lumi me fortësi 800 kg/cm^2 dhe të respektojë kushtet teknike të Standartit Shqiptar STASH- 512-78 dhe të mos ketë përmbajtje të huaj argjilore më shumë se 10% dhe materiale organike jo më shumë se 5%.

- **HEKUR PROFIL E SHIRIT**

1. Profila “L” prej çeliku me brinjë të barabartë me nr. profili 3.6, me brinjë $b=36\text{mm}$, trashësia $t=4\text{mm}$

2. Hekur shirit prej çeliku me gjerësi $b=35\text{mm}$ dhe trashësi $t=10\text{mm}$.

3. Profila kuadrat (stranxa) $(20 \times 40)\text{mm}$, $t=1.5\text{mm}$, $(40 \times 60)\text{mm}$ $t=2\text{mm}$, $(120 \times 120)\text{mm}$ $t=3\text{mm}$, $(100 \times 100)\text{mm}$ $t=4\text{mm}$.

4. Profila “U” $h=65\text{mm}$, $b=40\text{mm}$, $t=4\text{mm}$.

- **HEKUR BETONI**

Të jetë me këto përmasa $\varnothing 6 - 12\text{ mm}$ dhe $\varnothing > 12\text{mm}$, periodik. Duhet të jetë S 500 ose ekuivalent.

- **LËNDA E SHARRUAR** dimensioneve të ndryshme dhe cilësia sipas standarteve dhe kushteve teknike të përcaktuara në ç’do konstruksion. Dimensionet e drurit të sharruar variojnë si më poshtë:

Gjatësia 100-650cm

Gjerësia $\geq 5\text{cm}$

Trashësia 0.5-5cm

- **GOZHDË** ndertimi: Gjatësi 4-10cm në pako 5kg materiali celik.

- **TEL BARI**, material hekur spresori 1.2mm.

- **ELEKTRODAT** e saldimit Trashësia: 2.5 cm Gjatësia: 300cm Amperazhi: 50-100 Temp.e punes: 150-3000C Tipi: E6013.

- **TULLA** tipit “Bari” përmasave $9 \times 12 \times 20\text{ cm}$ materiali qeramik i paketuar në baleta 550 copë/secila.

- **LLAMARINË** e zezë spresori deri në 2.5mm e përmasave të ndryshme $100 \times 200\text{cm}$, $125 \times 220\text{ cm}$, $125 \times 2500\text{ cm}$, $125 \times 300\text{ cm}$ e paketuar në baleta 15 copë / secila.

- VIDA marangozie druri te dimensioneve 3.5 x 80, 3.5 x 100 paketimi 1000 copë/secila.
- BOJË:

Bojë vaji në paketim 5 litra dhe ngjyrat sipas kërkesës së Ndërmarrjes Mbulimi: për mbulim të plotë 10-12 m²/l, Hollimi: Me 15-20 % në volum, Koha e tharjes: Koha e plotë e tharjes 10 min Dora e dytë pas 8 orësh.

Bojë antiruxho në paketim 5 litra dhe ngjyrat gri ose e zezë, Mbulimi: për mbulim të plotë 8-10 m²/l, Hollimi: Me 5-10 % në volum, Koha e plotë e tharjes 30 min. Dora e dytë pas 8 orësh.

Bojë bikomponente Bojë bikomponentë plastikë në të ftohtë (pastë) Karakteristikat e produktit: Bojë bikomponente Pastë për realizimin e figurave Pastë, masë plastike me bikomponente e përdorur në të ftohtë për sinjalistikë rrugore, sipas normave EU 1871, dhe EN 1436, veçanërisht e përshtatshme për vijëzime me profile të ndryshme strukturore, si për këmbësore, vija stopi, banda zhurmuese, vijëzime aglomerat me pika etj, Koha e tharjes; ≤ 30 min. Ngjyrat; kordinatat e ngjyrave x,y sipas standartit për ngjyrën e bardhë; Faktori reflektues; $\beta \geq 0.80$. Dendësia relative; $\pm 2\%$ e vlerës së deklaruar ($\rho = 1.84 \pm 0.07 \text{ kg/l}$. EN ISO 2811-1; Faktori reflektues; ± 0.02 e vlerës së deklaruar $\beta = 0.87 (0.85 - 0.89)$.

Boje hidroplastike me baze uji, gjyra sipas kërkesave të ndërmarrjes, mbulimit 10-12 m²/l koha e tharjes 3-4 orë, hollimi 10-15% me uje , paketimi kova 3 , 6 ,9 Lt.

- TABELA SINJALISTIKE RRUGORE:

Tabela rrethore ϕ 60

Tabela drejtkëndore treguese të përmasave 40 x 60 cm, bashkë me pajisjet Kit për mbërthimin e tyre.

- GËLQERE e shuar, duhet të jetë e paketuar në thasë 10 Kg ose në thasë Big Bag 600 Kg.
- ZGARA, kapak gize për pusët do të ketë përmasa në plan 40 x 60 ose 50 x 70cm. Materiali – Gizë që plotëson normën EN 124, hapsirat garantojnë minimum 30 % të sipërfaqes në plan dhe duhet të përballojnë një ngarkesë prej 25T.

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Nr.an.	Emërtimi i materialit te ndertimit	Njësia	Sasia
1	1.19/3P	Rërë guri makinerie	m ³	70
2	639	Çakëll për betone (makinerie)	m ³	35
3	1.1/p	Gurë kave	m ³	80
4	635	Çakëll mbeturine për mbushje	m ³	300
5	34	Beton i gatshëm C20/25, me çakëll	m ³	1 850
6	An	Zgarë hekuri Ø4mm për shtresa betoni në rrugë me permasa (4.7*2)m, kuadrati (25*25)cm	copë	1 850
7	107	Çimento e zakonshme 42.5R	kg	18 000
8	265	Tubo betoni Ø600mm	ml	40
9	267	Tubo beton/arme Ø800mm, t=10cm	ml	30
10	272	Tubo beton/arme Ø1000mm, t=10cm	ml	30
11	1	Derrase pishe 5cm e stazhionuar	m ³	5
12	615	Lëndë e hollë e sharruar C II-III (3cm)	m ³	5
13	212	Gozhdë ndërtimi	kg	100

14	182	Vida druri 8,10cm	copë	2 100
15	1626	Llamarinë e zezë $\delta > 2.5\text{mm}$	kg	1 000
16	41	Hekur betoni periodik $\varnothing > 12\text{mm}$	kg	4 000
17	42	Hekur betoni periodik $\varnothing 6 \div 12\text{mm}$	kg	2 000
18	129	Tel bari	kg	30
19	395	Elektroda të zakonshme	kg	100
20	500	Blloqe betoni me vrima (20*20*40)cm	copë	400
21	120	Tulla me 6 vrima për mure ndarës	copë	1 500
22	51	Hekur profil ("L", "U" e kuadrat) dhe shirit	kg	1 000
23	817	Boje vaji e zmalto	kg	200
24	601	Boje antiruxhio	kg	100
25	897	Boje bikomponente për vijëzim rrugësh	kg	200
26	132	Boje hidroplastike	kg	100
27	954	Tabela rrugore D=60cm	copë	30
28	1428	Tabela drejtkendore tregimi (40×60)cm	copë	15
29	1120	Gëlqere e shuar (qull)	kg	1 000
30	278	Kapak gize	kg	500

Afatet e lëvrimit: Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër do të jetë 12 muaj nga data e lidhjes së saj. Malli do të furnizohet sipas nevojave dhe kërkesave të autoritetit kontraktor.

Në përfundim njësia e prokurimit;

Vendosi:

1. Miratimin e kriterëve të veçanta të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale ndërtimi”.
2. Miratimin e specifikimeve teknike të objektit “Blerje materiale ndërtimi”, hartuar nga Sektori i Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës Rrugore.
3. Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, neni 45, pika 2, kriter vlerësues të jetë: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.
4. Procedura për hapjen e ofertave do të zhvillohet në datën 14.07.2025, ora 13⁰⁰

NJËSIA E PROKURIMIT